



KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI
Prishtinë

KOLEGJI "BIZNESI"
Nr. 115/20 Data: 20.11.2020
PRIZREN



MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Neni 1

Palët nënshkruese të këtij memorandumi:

1. Kolegji BIZNESI- Prishtinë, rruga "Motrat Qiriazi" nr 29 të cilën e përfaqëson Dr. Shyqeri Kabashi -Dekan, dhe
2. Master Projekt shpk –Prizren Rr.Ali Hadri Nr.13 me NRB 810976095

Neni 2

Qëllimi i këtij Memorandumi

Ky Memorandum bashkëpunimi ka për qëllim përcaktimin e fushave të bashkëpunimit, kushteve dhe afatet themelore, në bazë të të cilave Kolegji BIZNESI- Prishtinë dhe Master Projekt shpk –Prizren, pajtohen për bashkëpunim.

Neni 3

Fushat e bashkëpunimit

1. Master Projekt shpk –Prizren do të ndihmojë dhe mbështesë në vazhdimësi Kolegjin Biznesi, në pranimin e studentëve për realizimin e praktikës, të bazuar në politikat e këtij institucionit.
2. Kolegji Biznesi do të mbështesë në vazhdimësi Master Projekt shpk –Prizren në aspektin e mbrojtjes nga zjarrit duke kontrolluar dhe servisuar aparaturat për shuarjen e zjarrit si dhe për ngritjen e kapaciteteve profesionale të personelit të saj, me programet e saj arsimore në të gjitha nivelet.
3. Kolegji Biznesi do të mbështesë Master Projekt shpk –Prizren me stafin e sajë akademik, për ligjërata nga lëmia: emergjencave, ekonomis dhe jurisprondencës-sipas nevojave që paraqet Master Projekt shpk –Prizren

Neni 4

Interpretimi dhe ndryshimi i memorandumit

1. Interpretimi i këtij Memorandumi do të bëhet në pajtim me Ligjet e Kosovës, duke e ruajtur parimin e reciprocitetit.

2. Afati i këti memorandumi është në kohë të pacaktuar. Ndryshimet dhe plotësimet e këti Memorandumi mund të bëhen vetëm me shkrim dhe të nënshkuara nga të dyja palët.

Neni 5
Kopjet e Memorandumit


Memorandumi është punuar në katër kopje origjinale, nga dy kopje për secilën palë.


Neni 6
Hyrja në fuqi

Ky Memorandum hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët.

PALËT NËNSHKRUESE

Kolegji BIZNESI Prishtinë
Dekani


Prof. Dr. Shyqer Kabashi



Master Projekt shpk –Prizren


Enis Mustafi



Nënshkuar në Prishtinë, me datë 19/11/2020